



REPUBLIKAE KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

GJ.A.nr. 747/22

Datë: 02.09.2022

Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Gjykatën (Ligji nr.06/L-054) dhe Rregullores Nr.02/2020 Për organizmin dhe veprimtarinë e brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, e bazuar në vendimin KGJK.nr.288/2021 të datës 18.10.2021, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i propozon Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, për miratim:

NDRYSHIMIN E PLANIT TË PUNËS SË GJYQTARËVE DHE ADMINISTRATES SË  
GJYKATES THEMELORE NË PRISHTINË PËR VITIN 2022

**Caktimin e gjyqtarit Ngadhnjim Arrni nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë.**

**A r s y e t i m**

Kryetarja e gjykatës, pas diskutimit në kolegjiun dhe aprovimit njëzëri nga gjyqtarët, i propozon Këshillit Gjyqësor të Kosovës të miratoj ndryshimin e Planit të punës për vitin 2022 për Gjykatën Themelore në Prishtinë, në atë mënyrë që gjyqtari Ngadhnjim Arrni të caktohet nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal në Departamentin e Krimeve të Rënda.

Pas, pranimit të vendimit disiplinor të KGJK-së me nr.318/2022 të datës 28.07.2022, i vërtetuar nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A.A.nr.10/2022 të datës 22.08.2022, me të cilin vendim një gjyqtare nga Departamenti i Krimeve të Rënda është transferuar në Departamentin e Përgjithshëm, është paraqit nevoja për sistemim të një gjyqtari tjetër në këtë pozitë që për momentin ka mbet vakante.

Propozimi për ndryshim të planit të punës – caktimi i gjyqtarit në fjalë, është i bazuar në kualifikimin e tij si gjyqtar, gatishmërinë si dhe performancën e gjyqtarit, e që i njëjti propozim është aprovuar edhe nga Kolegjiun i gjyqtareve të Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni Penal dhe po ashtu si kryetare e kësaj gjykate vlerësoj se me këtë ricaktim do të rritet efikasiteti i punës së gjykatës.

Pjesa tjetër e planit të punës, mbetet e pandryshuar.

**Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë**

**Albina Shabani – Rama**

